

VENDIM
Nr. 63, datë 29.1.2025

PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE
PUBLIKE PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2025, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) dhe njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

KALENDARI PËR MENAXHIMIN E SHPENZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2025

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Janar	8	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2026–2028.
Janar	15	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2026–2028.
Janar	17	SASPAC/KM/KPS	Përgatit dhe diskuton Projektdokumentin e Politikave Prioritare 2026–2028.
Janar	24	SASPAC	Paraqet Projektdokumentin e Politikave Prioritare 2026–2028 për miratim në KM.
Janar	29	KM	Miraton Dokumentin e Politikave Prioritare 2026–2028.
Shkurt	19	MF	Paraqet në KM tavanet përgatitore të përgatitjes së PBA 2026–2028, për fazën strategjike.
Shkurt	26	MF	Dërgon Udhëzimin e Përgatitjes së Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore.
Mars	7	KM	Paraqet për informacion në Kuvend Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2026–2028.
Mars–prill	3 mars–25 prill	Njësitë e Qeverisjes Qendrore	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore.
Prill	29 prill–30 prill	Njësitë e Qeverisjes Qendrore	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile për PBA 2026–2028.
Maj	1	Njësitë e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MF kërkesat e tyre buxhetore.
Maj	2–16 maj	MF	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore.
Maj	2–16 maj	SASPAC/KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e prioritetëve të politikave 2026–2028.
Maj	19–30 maj	MF	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Maj	30–31 maj	MF/SASPAC	Prezanton dokumentin e PBA 2026–2028 me shoqërinë civile.
Qershor	2	MF	Paraqet në KM Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Qershor	11	KM	Miraton Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Qershor	16	MF	Përgatit dokumentin e PBA 2026–2028 dhe tavanet

			përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2026–2028.
Qershor	18	MF	Paraqet dokumentin e PBA 2026–2028 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2026–2028, për shqyrtim dhe miratim në KM.
Qershor	20	SASPAC/KM/KPS	Përgatit Dokumentin e Rishikuar të Politikave Prioritare 2026–2028 <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Qershor	25	KM	Miraton dokumentin e PBA 2026–2028 dhe tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2026–2028.
Qershor	26	SASPAC	Paraqet Dokumentin e Rishikuar të Politikave Prioritare 2026–2028 për miratim në KM <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Korrik	2	KM	Miraton Dokumentin e Politikave Prioritare të Rishikuar <i>(në rast se shihet e nevojshme)</i> .
Korrik	4	MF	I paraqet Kuvendit për informacion dokumentin e PBA 2026–2028.
Korrik	10	MF	Dërgon Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit në fazën teknike, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Korrik–gusht	10 korrik–29 gusht	Njësitë e Qeverisjes Qendrore	Përgatitin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Shtator	1	Njësitë e Qeverisjes Qendrore	Paraqesin në MFE kërkesat e rishikuara buxhetore.
Shtator	2–12	MF	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore.
Shtator	2–12	KM	Analizojnë kërkesat buxhetore bazuar në dokumentin e rishikuar të prioriteteve të politikave 2026–2028.
Shtator	15–24	MF	Organizon seancat dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.
Tetor	25 shtator–10 tetor	MF	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2026 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2026–2028 dhe i paraqet për shqyrtim në KM.
Tetor	13	KM	Miraton Projektbuxhetin e vitit 2026, si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2026–2028.
Tetor	20	MF	Dërgon për informacion në Kuvend një kopje të dokumentit të rishikuar të PBA 2026–2028, të miratuar nga KM-ja.
Tetor	20	KM	I paraqet Kuvendit Projektbuxhetin e vitit 2026.